



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.309/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryesues, Kujtim Pasuli dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Kumrije Baçaj, nga subjekti politik Partia Social Demokrate (PSD), me seli në Prishtinë, dega Deçanë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të kërkesës për rinumërim të votave dhe mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 24.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZL. Anr.309/2025 e datës 22.10.2025, parashtuar nga Kumrije Baçaj, nga subjekti politik Partia Social Demokrate (PSD), me seli në Prishtinë, dega Deçan,, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të kërkesës për rinumërimin e votave dhe mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datë 22.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Kumrije Baçaj, nga subjekti politik Partia Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega Deçan, në të cilën thekson se ka dyshime dhe kërkon që të rinumërohen vendvotimi në shkollën fillore Sylë Alaj në Drenoc në numrat 0103/01, 0103/02, 0103/03, 0103/04, 0103/05, vendvotimi në shkollën e mesme Vëllezërit Frashëri Deçan në numrat 0101/01, 0101/02, 0101/03, 0101/04, 0101/05, 0101/06, vendvotimi SHFMU Lidhja Prizrenit Carabreg të Deçanit të gjitha vendvotimet 0102/01, 0102/02, 0102/03, 0102/04, 0102/05. E njëjta pretendon se i mungojnë pastaj votat nga diaspora nga votuesit Selmon Baçaj Agron Baçaj, Driton Baçaj, Florentina Baçaj, Altin Baçaj, Florina Baçaj, Albin Baçaj, Albin Baçaj, Brahim Baçaj, në vendvotimin në Gjermani – Karlslune, Hamdi Nitaj Svendi Shtutgen alen, Shtutgard Florent Berisha-Gjermani, Fjolla Haklaj, Korab Haklaj dhe Zenel Lokal Stutgard.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se lidhur me pretendimet e palës ankuese thekson se në lidhje me pretendimet e palës ankuese për rinumërim të votave në vendvotimet e specifikuara më sipër, KQZ, thekson se rezultate preliminare të zgjedhjeve mund të korrigjohen në përputhje me parag. 3 të nenit 14 të rregullores Zgjedhore 16/2024. Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës ankuese për pikën e dytë të ankesës, lidhur me votat e votimit jashtë vendit, ju njoftojmë se, me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime, Në faqen 14

të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime), Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17 Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Deçanit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "Duke u bazuar në kërkesën tuaj, konsideroj që procesi në Qendrat Votimit 0101, 0102 dhe 0103 ka qenë i rregullt dhe pa probleme dhe me rëndësi edhe në QKN këto Vendvotime nuk kanë patuar mos përputhje të rezultateve. Përveç Qendrës së Votimit në 0102/01 ku ishin disa fletëvotime të pavulosura, për të cilin rast KKZ ka njoftuar KQZ me e-mail me datën 15.10.2025. Procesi i numërimit në QKN në Deçan ka përfundua me datën 15.10.2025 në ora 15:00" në bazë të deklaratës ZEKZZ. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga, KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tyre, Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçantë; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre,

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Kumrije Baçaj, nga subjekti politik Partia Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega Deçan, në të cilën thekson se ka dyshime dhe kërkon që të rinumërohen vendvotimet 0103/01, 0103/02, 0103/03, 0103/04, 0103/05, 0101/01, 0101/02, 0101/03, 0101/04, 0101/05, 0101/06, 0102/01, 0102/02, 0102/03, 0102/04, 0102/05, dhe pretendimet se i mungojnë votat nga diaspora nga votuesit Selmon Baçaj Agron Baçaj, Driton Baçaj, Florentina Baçaj, Altin Baçaj, Florina Baçaj, Albin Baçaj, Albin Baçaj, Brahim Baçaj, Hamdi Nitaj, Florent Berisha, Fjolla Haklaj, Korab Haklaj dhe Zenel Lokal, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë me të cilën kërkon të rinumërohen votat dhe arsyetimi se i mungojnë votat nga diaspora. Paneli këto pretendime nuk ka arritur që të i vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa personave – votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë e votës, prandaj edhe për këtë arsye nuk e mori parasysh këtë pretendim.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.309/2025 datë 24.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.